

**RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE
NDIKIMIT NE MJEDIS PER OBJEKTIN:
FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE
AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM**

Vendodhja : Fshati Ftere, Njesia
Administrative Lukove, Rrethi Sarande,
Qarku Vlore.

Kërkues: Subjekti: "C.I.V." Sh.p.k

Referuar shtojces: (sipas ligjit 10440 shtojca
II pika 10/a)

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENTS CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu

Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Gusht, 2015

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

TABELA PERMBLEDHESE

1	TE PERGJITHSHME.....	2
1.1	HYRJE.....	2
1.2	TE DHENA TE PERGJITHSHME.....	3
2	PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL.....	4
2.1.	TE PERGJITHSHME	4
3	PERSHKRIM I PROJEKTIT	10
3.1.	QELLIMI I PROJEKTIT	10
3.2.	TE DHENA TEKNIKE TE AKTIVITETIT	10
4	PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT	18
	MJEDISI FIZIK	18
	GJELOGJIA	18
	GJEOMORFOLOGJIA DHE RELIEVI.....	18
	TOKAT	19
	UJËRAT	19
	KLIMA.....	20
	MJEDISI BIOLOGJIK	21
	MJEDISI SOCIO-EKONOMIK	23
5	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS	24
5.1.	NDIKIME TE RENDESISHME GJATE NDERTIMIT	24
5.1.1.	Shkarkime ne uje	24
5.1.2.	Emetimet ne ajer.....	24
5.1.3.	Zhurmat dhe vibrimet.....	24
5.1.4.	Ndikimi ne toke.....	25
5.1.5.	Ndikimi ne flore/faune	25
5.1.6.	Mbetjet e prodhuara	25
5.2.	NDIKIME TE TJERA	25
6	MASAT KRYESORE LEHTESUESE	26
6.1.	MASAT LEHTESUESE QE DO TE NDERMERREN GJATE SHFRYTEZIMIT TE OBJEKTIT	26
7	PROGRAMI MONITORIMIT	27
7.1.	SKEMA E MONITORIMIT TE TREGUESVE MJEDISOR.....	27

1 TE PERGJITHSHME

1.1 Hyrje

Vendi yne gjate viteve te fundit ka miratuar nje sere ligjesh dhe vendimesh te Keshillit te ministrave ne fushen e mbrojtjes se mjedisit, duke permiresuar ndjeshem legjislacionin mjedisor dhe social ekonomik te vendit. Gjithashtu gjate kesaj periudhe Shqiperia ka nenshkruar edhe nje sere konventash dhe protokolleesh ne klimen e permiresimit te cilesise mjedisore ne vend dhe rajon. Disa prej ketyre konventave te nenshkruara jane:

- Konventa e Aarhus per akses ne informacion, pjesemarrje te publikut ne vendim marrje ambjentaliste dhe akses te drejtesise ne ceshtjet ambjentaliste, te ratifikuar me Ligjin Nr. 8672, date 26 tetor 2000,
- Konventën e Rio De Janeiro-s per Biodiversitetin, te ratifikuar me 10 Nentor 1996,
- Konventa per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkuftar ESPOO, Finlandë, me 25 shkurt 1991
- Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha, Gjenevë, Zvicër, me 13 nëntor 1979.
- Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës Ne Bernë, 19 shtator 1979. Etj.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit te projektit ne kete zone. Projekti eshte realizuar per ndertimin:e nje"Fabrike per Perpunim dhe Ambalazhim e Ujit te Pijshem" e ndodhur ne Fshatin Ftere,Njesia Administrative Lukove, Rrethi Sarande, Qarku Vlore.


Ne kete Vleresim do te paraqesim gjendjen, ndikimin e ketij projekti mbi mjedisin e zones dhe mbi njerezit (qofshin banore te zones perreth, punonjes apo vizitor). Gjithashtu do te shqyrtojme faktoret pozitiv dhe negativ mjedisor, do te paraqesim skemat e rehabilitimit, masat zbutese dhe reduktimin e impakteve negative.

1.2 Te dhena te pergjithshme

Objekti ne fjale eshte ne perputhje me planin urbanistik te zones dhe jane projektuar vendparkimi per automjetet, rruge te brendshme si dhe ndarja nga rruga kryesore me brez te gjelber, nje mjedis perreth i sistemuar kendshem dhe i gjelberuar.

Zona e studiuar, konsiderohet si nje zone me zhvillim turistik. Fshati Ftere ndodhet jashte zones se planifikuar ne Planin per Zhvillimin e Bregdetit, e aprovuar nga K.RR.T.R.SH Gjithashtu ne funksion te zones, lind nje kerkese me e larte persa i perket respektimit rigoroz te normativave te shfrytezimit te siperfaqes dhe distancave normative te percaktuara nga “Rregullorja e Urbanistikes” si dhe transparence, bashkeveprim dhe reference ne peizazhin e gjelber.

Plan-vendosja e objekteve



2 PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

2.1. Te pergjithshme

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situate normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Por sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative ne mjedis dhe shendet te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovoje zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM-se ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje dokument kyç per vendimarrjen per miratimin e nje zhvillimi te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori. Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar. Qellimi afatgjate i VNM eshte te promovoje zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

1. Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
2. Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
3. Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
4. Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit te propozuar.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise kerkohet: "Mirembajtje e nje mjedisi teper te shendetshem dhe ekologjik per brezat e tanishem dhe te ardhshem". Kjo, por edhe opinionin e gjithe shoqerise i shprehur nepermejt ligjeve te tjera, detyron marrjen e masave imediate per rehabilitimin e mjedisit te degraduar gjate "epokes se industrializimit socialist" dhe ruajtjen e tij nga aktivitetet e sotme prodhuese, perpunuese apo ndertuese qe gjithashtu mund te shkaktojne demtime te mjedisit. Legjislacioni ne lidhje me ruajtjen e mjedisit eshte ne perputhje me normativat Europiane te mbrojtjes se tij ndonese cilesia mjedisore eshte ende ne parametra mjaft te ulet, kjo edhe ne krahasim me vendet e tjera Europiane.

Ligji i pare per mbrojtjen mjedisore daton ne vitin 1993 dhe shprehet se: "Te gjitha veprimtarite e personave fizike dhe ligjore, vendas apo te huaj, qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise, do ti nenshtrohen vlersimeve mjedisore". Me tej, Ligji Nr. 8934, mbi mbrojtjen mjedisore percakton se: "Mbrojtja e mjedisit eshte detyrim i te gjithe shtetasve dhe individeve me veprimtari ne Shqiperi"

Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteve te ndryshme te cilat mund te kene potencial ndotes ne mjedis

Sipas Ligjit Nr. 10431, date 09.06.2011 Per mbrojtjen e mjedisit, me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

Parimet e mbrojtjes së mjedisit

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrojtjen e integruar te përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

2.2. Legjislacioni

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri: “Ligji Per mbrojtjen e mjedisit” dhe “Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.

Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit European per mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky raport hartohet bazuar ne kerkesat e Njesive te Qeverisjes Vendore per raport te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per paisje me Leje Zhvillimore te objekteve te reja qe ndertohen. Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, hartohet vetem per fazen e kryerjes se punimeve te ndertimit te objektit.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

- VNM e permbledhur.
- VNM i Thelluar.

Aktiviteti ne vleresim, ne baze te klasifikimit te tij si aktivitet me ndikim te vogel ne mjedis, klasifikohet si raport i permbledhur i VNM.

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te vecante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder ligjet me specifike qe kane lidhje te drejtperdrejte me projektin ne vleresim, mund te permendim:

- Ne ligjin Nr. 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” theksohet ne kapitullin V (VNM) neni 25 se:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

- Ne Ligjin Nr.10 440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” ne kreun II, neni 7 per “Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis” thuhet:

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së dhe licencimi, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis perfshin indentifikimin, saktesimin dhe vleresimin e drejtperdrejte dhe te terthorte te projektit ne mjedisin ku do te zbatohet, si dhe percaktimi i masave per te parandaluar dhe zbutur demtimet ne mjedis qe ne fazen fillestare te tij.

2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor

Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) i kushtetutes shkruhet se:

"Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotesimin e nismes dhe te pergjegjesise private, synon:

Neni d): nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Sipas Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", Ministria e Mjedisit eshte autoriteti pergjegjes per rishikimin e dokumentit VNM te pergatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrise se mjedisit.

Pervec Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", Parlamenti i Republikes se Shqiperise miratoi edhe Ligjin Nr. 10440 Date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis". Ky ligj eshte zhvilluar dhe bazuar ne Direktivat e EU dhe praktikat nderkombetare te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, ketë VNM dhe mjedisin perfshijne:

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis"**
- **Ligji Nr 8652 Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore, dt 31.07.2000.**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"**
- **Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 "Per planifikimin e territorit"**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".**
- **Ligji 8906 date 06.06.2002 "Per zonat e Mbrojtura", azhornuar me ligjin 9868 date 04.02.2008**
- **Ligji 8102 date 28.03.1996 "Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura", i ndryshuar.**
- **Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të Mjedisit"**
- **Vendimi Nr.247, datë 30.4.2014 "Për percaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis".**

- **Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.**
- **Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”**
- **Vendim Nr. 16, date 14.01.2012 “Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor”**
- **Vendim Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”**
- **Udhezim Nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen ministria e mjedisit për procesin e vnm-së”**

2.4. Metodologjia

Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik dhe juridik. Ky raport vleresimi pergatitet me kerkese te investitorit. U kryen inspektime ne terren per te konstatuar vendodhjen, karakteristikat territoriale te kesaj zone, gjendja e faktoreve te mjedisit, si dhe per te terhequr mendimin e komunitetit te zones dhe zhvillimin e aktivitetit.

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit per procedurat shqiptare te VNM-se

Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar	Procedura qe Duhet Ndjekur (Duke plotesuar Standartet Shqiptare)
Aneksi i Ligjit 10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”	Ky aktivitet per fazen e ndertimit nuk ka detyrime per paisje me leje mjedisore, por vetem ti nenshtrohet procedures paraprake te VNM, sipas kerkesave te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 Per VNM, VKM Nr. 13, date 04.01.2013 Per VNM.

3 PERSHKRIM I PROJEKTIT

3.1. Qellimi i projektit

Projekti ne vleresim ka si qellim ndertimi e nje "Fabrike per Perpunimin dhe Ambalazhimin e Ujit te pijshem", e ndodhur ne lindje te rruges nacionale Vlore-Sarande rreth 6 km(linje ajrore) ne lindje te fshatit Borsh, Rrethi Sarande, Qarku Vlore. Nga ana topografike perfshihet ne planshenten K-34-136-B-d e shkalles 1:25000. Me koordinata: X 44 04 600, Y 44 43 550 Punimet qe do te kryhen ne ndertimin e godines jane punime te ndertimit. Ky projekt do te realizohet nga subjekti "C.I.V." sh.p.k dhe do te kete nje siperfaqe totale te prones prej 4800 m², dhe nje siperfaqe ndertimi 1570 m², prone shteterore.

3.2. Te dhena teknike te aktivitetit

Zhvilluesi, per realizimin e aktivitetit te tij do te paiset me te gjitha miratimet perkatese te lejeve te nevojshme per ndertimin e tij. Ky objekt eshte ne perputhje me planin urbanistik te miratuar.

Pronesia e truallit te propozuar per ndertim te ketij objekti eshte prone shteterore.

Objekti ka keto te dhena urbanistike:

 Siperfaqe e prones	4800 m²
 Siperfaqe ndertimi	1570 m²

Mbetjet e ngurta te punimeve te ndertimit do te menaxhohen kryesisht ne sheshin e ndertimit per mbushje dhe sistemim te siperfaqeve te lira dhe pjesa e dheut te germuar do te depozitohet ne mjedise te caktuara nga Njesia Administrative Lukove. Persa i perkete ujerave te zeza te gjeneruara nga aktiviteti human ne keto objekte do te menaxhohen nga Njesia Administrative, pasi kanalizimet e godines do te lidhen me sistemin e kanalizimeve ekzistues te zones. Subjekti kerkues deklaroi se nuk do te shkarkohen ujera te perdorur ne mjedisin e zones dhe nuk do te kete grumbullim te mbetjeve te ngurta ne kete zone


**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

Vendodhja e objektit

Objekti ne vleresim eshte nje “Fabrike e Perpunimit dhe Ambalazhimit te Ujit”.

Adresa e ketij objekti eshte: Fshati Ftere, Njesia Administrative Lukove, Rrethi Sarande, Qarku Vlore.

Pamje satelitore te sheshit te propozuar per zhvillim





Vendi i ndertimi te Fabrikes per perpunimin dhe ambalazhimin e ujit te pijshem bie prane Monumentit te Natyres, ne baze te vendimit Nr 676, date 20.12.2002 “Per shpalljen Zone e Mbrojtur te Monumenteve te Natyres Shqiptare” ne fshati Ftere ndodhet **Monumenti i natyres: “Burimet Karstike te Fteres”**.


Ne nje Monument Natyre zbatohet shkalla e I-re e mbrojtjes, e cila nuk lejon ndertimin e ojeketeve.

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
 FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
 VLORE**

Harte e Zones se Mbrojtur per Monumentet e Natyres



**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**



Fabrika e prodhimit te ujit te ambalazhuar duke shfrytezuar burimet natyrale qe rrjrdhin 1,8 km nga qendra e Fshatit Ftere

Ne projektin e kesaj e kesaj fabrike, do te jete me dimensione 54x24 m e ndare ne 3 kampata te cilat do te jene te organizuara si me poshte:

- ✚ Ne kampatin e pare, me dimensione 24x17 m, do te instalohen makinerite e impjantit te ujit sipas skemes teknologjike te hartuar
- ✚ Ne kampaten e dyte, me dimensione 24x17 m, do parashikohen dy magazina me rreth 200 m² secila, per magazinimin e ujit te ambalazhuar
- ✚ Ne kampaten e trete, me dimensione 24x17 m, te parashikohet nje magazine per mbajtjen e lendeve te para si dhe ambalazheve rezerve

Objekti do kete lartesi nga toka me gjatesi 1m e 15 cm, si dhe nje platforme te jashtme me gjatesi rreth 20 m te shperndare ne tre hyrje te magazinave, ne te cilen do te shkarkohen prodhimet e gatshme. Dyert e magazinave te kene nje hapje minimale prej 30 m dhe lartesi jo me pake se 2 me 40 cm, Ne muret rrethuese te objektit te hapet dritarre horizontale per

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

ndricin natyral sipas normativave ne fuqi. Lartesia e paster e ambjentit te brendshem te linjave te prodhimit te jete jo me pake se 6 m. Ne nje nga ambjentet e magazinave te parashikohen 2 zyra dhe nyje sanitare per kontrolloret dhe personelin e personalizuar. Dyshemeja e te gjithë objektit eshte parashikuar me shtrese te forte per te mos u demtuar nga ecja e karreleve dhe piruneve me bateri, lehtesisht e pershtatshme per industrine ushqimore. Ne tavane parashikohet ndricim artificialme nivelin 400 lux me ventilim mekanik. Muret e brendshem te linjes se prodhimit te suvatohen me suva te thjeshte dhe te vishen deri ne lartesine 2.5 mme pllaka qeramike. Muret e brendshmete cilat nuk vishen me qeramike te lyhen me boje hidromate. Dyert e brendshme qe lidhin magazinat me njera-tjetren te jene te realizuara me material metalik. Dritaret te realizohen me material plastik ose duralumini. Konstruksioni i objektit te behet i tipit b/a me bazamente te tipit plint ose konstruksion metalik. Muret anesore trajtohen si mure tulle jo me pak se 20 cm gjeresi. Ne sistemimet e jashtme te merret parasysh relievi, si dhe rrethqarkullimi i lirshem i mauneve , te cilat sherbejne per te transportuar prodhimin, ndersa pjeset e tjera te siperfaqes te gjelberohen me bare dhe peme dekorative. I gjith trualli te rrethohet ne perimetrin e tij deri ne lartesi 1.8 m Ne sistemimet e jashtme parashikohet ndricimi dekorative dhe ndricim i sigurise. Pjese e sistemimeve te jete edhe rruga lidhese e truallit me rruge nacionale te fshatit Ftere. Ne sherbim te prodhimit te parashikohet nje objekt 2 katesh ne te cilin do te vendosen ambjentet si:


Laboratore per analizat e mallrave te prodhuar dhe lendeve te para (3 njesi)

Zyra per administraten (3njesi)

Zyre per drejtorin

Mense dhe kuzhine per gjith personelin

Apartament banimi bashke me ambjentet ndihmese te tij



3.1. Lidhja e objektit me infrastrukturen Inxhinierike

Objekti, ne baze te studimit te Planit te Pergjithshem Vendor, do te paiset me te gjithë infrastrukturen inxhinierike te nevojshme. Shenimet e formularit 3/1 vertetojne se zhvillimi i zones dhe ndertimi i ketij objekti nuk do te ndikojë ne demtimin ose devijimin e infrastruktures inxhinierike ekzistuese. Deri ne ndertimin e nje sistemi te ri kanalizimesh per te gjithë zonen e studiuar, objekti do te plotesoje nevojat e tij per uje higjeno-sanitar nepermjet shfrytezimit te rrjetit ekzistues dhe persa i perket sistemit te shkarkimit te ujerave te zeza, do te lidhen me kanalizimet ekzistuese ne zone sic jane ato te objekteve te ndertuara me heret.

Mbetjet e ngurta do te menaxhohen ne bashkepunim me Njesin Administrative Lukove dhe do te percaktohet vendi i depozitimit te tyre nga Bashkia, pasi te jete miratuar leja e zhvillimit. Ne kete faze te projektit nuk eshte percaktuar ende destinacioni i mbetjeve inerte. Pastrimi i mbetjeve urbane do te kryhet nepermjet vendosjes se koshave te mjaftueshem per stafin e punes dhe sherbimi i pastrimit te mbetjeve te ngurta urbane do te kryhet nga firma pastruese e zones, e cila i grumbullon keto mbetje ne Landfillin e Sharres.

Foto e Infrastruktures



3.2. Përshkrimi i proceseve teknologjike të projektit

Proceset teknologjike ne kete projekt jane ato te fazes ndertimore, nepermejt punimeve te ndertimit te cilat do te kryhet nga firma ndertuese.

Disa prej proceseve kryesore te punimeve ndertimore do te jene:

- Rrethimi i sheshit te ndertimit
- Pastrimi i sheshit te ndertimit nga struktura e perkohshme ose objektet ekzistuese ne kete zone.
- Germimi dhe hapja e themeleve te objektit
- Betonimi i themeleve
- Ngritja e struktureve prej betoni dhe hekuri (betoni blihet i gatshem nga prodhuesit)
- Punimet e mbuleses se objektit
- Muratura, suvatimet, instalimet inxhinierike etj.
- Sistemimi i shesheve te lira rreth objektit, rruget hyrese e dalese
- Rehabilitimi i hapësirave te gjelberta te projektuara, etj.

3.3. Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lëndëve të para

Lendet e para te perdorura do te jene kryesisht llaci i betonit i cili blihet i gatshem nga firmat e prodhimit te betonit ne zone, hekuri per strukturen mbajtese te objektit, tulla dhe tjegulla per mbushjen e mureve dhe te mbuleses, material poliesteroli per izolim, rere dhe gelqere per suvatimin e mureve, dyer dhe dritare metalike dhe instalimet inxhinierike te brendshme. Shkarkimet e ujerave te zeza, do te lidhen me sistemin e kanalizimeve te zones, ku pas ndryshimeve te viteve te fundit, duhet te ndertohtet nje rrjet i ri me kapacitete me te medha. Studimet duhet te hartohen per nje periudhe afatmesem dhe afatgjate.

3.4. Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet ne mjedis gjate fazes ndertimore do te jene kryesisht pluhurat nga punimet e ndertimit ne kantier (LNP), si dhe zhurmat ne mjediset e punes nga makinerite e punimeve te ndertimit. Ky efekt mund te transmetohet edhe ne mjediset e zones perreth nese nuk kryhet larja dhe pastrimi i mjeteve para daljes se tyre nga kantieri dhe lagia e siperfaqeve te pa shtruara gjate sezonit te thate. Keto ndikime do te jene te perkohshme dhe nuk do te kene veti akumuluese ne mjedisin e zones. Mbetjet e ngurta nga faza ndertimore do te jene ambalazhe te produkteve te ndryshme te cilat jane te riciklueshme dhe do te menaxhohen nga firma pastruese e territorit urban.

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

Persa i perkete mbetjeve inerte nga prishja e objekteve ekzistuese, ne vecanti ato te cilat kane eternite ne mbulesen e tyre, duhet te menaxhohen nga Bashkia “ne menyre te integruar”, sipas kerkesave te Ligjit per menaxhimin e integruar te mbetjeve, pasi permbajtja e eterniteve ka perberje te asbestit, i cili eshte nje element teper i demshem per shendetin e njeriut dhe gjallesave te tjera. Gjate fazes funksionimit, nga aktiviteti human do te kete shkarkime te ujerave te zeza, te cilat kane cilesine e ujerave urbane si ne te gjitha zonat e tjera te banuara. Keto shkarkime do te kryhen ne sistemin ekzistues te kanalizimeve te zones, kjo deri ne investimin e Bashkise Himare per nje sistem te ri kanalizimesh per te gjitha zonen e re te zhvillimit per te plotesuar kapacitetet e zhvillimeve te tjera ne zone.

Persa i perkete sasise se dheut qe do te hiqet nga sheshi i ndertimit, Ky proces eshte ende nje problem serioz per zhvilluesit sot, ku ende nuk eshte percaktuar perfundimisht menyra e menaxhimit te tij. Por subjekti jo e e perdore sasine e dheut rehabilitimin e siperfaqes perreth objektit qe do ndertoje.

4 PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

Mjedisi fizik

Fshati Lukove është i pozicionuar midis qyteteve, Sarandë dhe Himarë, jo më larg se 30 minuta udhëtim, nga këto dy pika. Fshati shtrihet në dy kodra të veshura me plantacione ullinjsh dhe portokallësh në një lartësi prej 150 m nga bregu i detit dhe në bregdetin e saj të gjerë strehon një numër të madh plazhesh të përmasave të ndryshme, duke filluar që nga plazhet e vogla me një atmosfere tejet intime deri tek plazhet popullore e festive të mirënjohura tanimë për pushuesit shqiptare, si plazhi i Shpellave dhe ai i Bunecit.

Gjeologjia

Rajoni në studim ndërtohet nga depozitime që datojnë nga jurasiku e deri në kuaternar. Nga pikpamja litologjike zona në studim ndërtohet kryesisht nga formacione gëlqerore e terrigjene dhe më pak depozitime eluvialo-deluviale.

Formacionet gëlqerore, të cilat përfaqësojnë edhe formacionin rrënjësor të zonës në studim, paraqiten masivë me ngjyrë të bardhë dhe gri dhe kanë aftësi të mira ujëmbajtëse. Kufiri ndërmjet tyre dhe formacionit flishor është në nivelin e rrugës automobilistike.

Formacionet terrigjene, ndërtohen nga depozitime flishore të ndërthurjes argjilo-alevrolitoranore, ritëm mesëm deri ritëm trashë. Elementët e shtresëzimit janë me shtrirje 320 – 330° dhe rënie 30 – 35° në juglindje. Shpesh për shkak të rrudhosjeve këta elementë ndryshojnë nga njëri sektor në tjetrin. Formacioni rrënjësor nuk del gjithnjë në sipërfaqe.

Formacionet e kuaternarit, të cilat përfaqësojnë formacionin mbulesor të zonës, ndërtohen nga depozitime eluviale dhe eluvialo-deluviale, të cilat janë formuar si rrjedhojë e shpërbërjes së formacionit flishor argjilo-alevrolitoranor. Këto depozitime përfaqësohen nga dhera suargjilorë të natyrës deluviale, me përmbajtje të materialit copëzor si dhe popla e blloqe shkëmbore të përbërjes gëlqerore, të cilat krijojnë një mbulesë potente me trashësi vende-vende mbi 2-3 m

Gjeomorfologjia dhe relievi

Bregu i Detit Jon është kryesisht shkëmbor, karakterizuar nga kodra dhe shpate të pjerrëta që në disa zona bien drejt mbi det. Shkëmbinjtë e bregdetit të Jonit janë kryesisht gëlqerorë ndërsa në grykëderdhjet e përrenjeve dhe lumenjve që derdhen në det ka sedimente zhavorre të përbërjes të ndryshme minerale. Në këto zona, përreth grykëderdhjeve të Jonit janë formuar plazhe të bukura.

Në pjesën veriore të Jonit, nga Orikumi në Sarandë egziston një diferencë e kodrave në lartësinë nga niveli i detit, që varion nga 600 – 1000 m, ndërsa nga qyteti i Sarandës deri në Kepin e Stillos, relievi është më i moderuar dhe shpatet bregdetare më të ulta, me lartësi nga niveli i detit 200 – 300 m.

Tokat

Tipi kryesor i tokave që takohet në zonën e propozuar për zbatimin e projektit është ai i Tokave të Hinjta Kafe. Ato janë karakteristike për kodrat dhe malet e ulta të zonës bregdetare dhe takohen në lartësitë 0-200 m mbi nivelin e detit. Në disa zona shtrihen deri në 600 m lartësi.

Tokat e Hinjta Kafe formohen në kushte të klimës mesdhetare fushore dhe kodrinore, mbi materiale primare me natyrë të ndryshme. Në sistemin kodrinor bregdetar të vendit, ku përfshihet edhe zona në studim, ato janë zhvilluar mbi depozitime proluviale dhe deluviale të formuara nga alterimi i gëlqerorëve. Njëkohësisht janë toka që zhvillohen në kushte të një relievi heterogjen. Tokat e Hinjta Kafe shfaqen me profil të diferencuar në shkallë të ndryshme.

Densiteti vëllimor i tyre shkon 1.02 – 1.51 g/cm³ ndërsa densiteti specifik 2.63 – 2.75 g/cm³. Kapaciteti ujëmbajtës fushor luhetet ndërmjet 27% dhe 34% dhe karakterizohen nga plasticitet mesatar. Në horizontin e punueshëm kanë porozitet total 52-59% dhe të ajrimit 17-30.5%. Sa i takon karakteristikave kimike janë toka neutrale deri në lehtësisht bazike, pH ujqor 7.4 – 7.6, me përmbajtje mesatare humusi dhe N në horizontin A. Janë të varfëra me P, të pasura me K dhe CaCO₃ dhe të saturuara me baza. Raporti SiO₂/Al₂O₃ është 4 – 5, ndërsa ai SiO₂/Fe₂O₃ është 39. Krahasuar me nëntipet e tjera, këto toka në përgjithësi kanë cilësi fizike dhe strukturë të mirë, si pasojë e përmbajtjes së humusit, CaCO₃ dhe bazave në kompleksin thithës.

Ujërat

Njësia Bregu i Detit përshkohet nga disa lumenj, përrenj dhe burime, ndër të cilët më të rëndësishmit janë përroi i Dukatit, Kudhësit dhe Borshit në pjesën veriore dhe lumenjtë e Bisticës, Kalasës dhe Pavllos në pjesën jugore. Laguna e Butrintit është një trup ujqor shumë i rëndësishëm në zonën jugore të Jonit Shqiptar ndërsa zona veriore e Jonit vlerësohet si e varfër në burime ujqore dhe hidrologjinë sipërfaqësore.

E njëjta gje mund të thuhet edhe për zonën ku propozohet të zhvillohet aktiviteti akuakulturë. Siç shihet edhe nga harta, zona e vendosjes së koshave gjendet mjaft e distancuar nga grykëdherdhjet e lumenjve. Por ajo përshkohet nga disa përrenj me karakter stinor si, prr. Gares, prr. Llaktoricës, prr. Sinarit, prr. Nikullësit, prr. Mazerekut, prr. Ndreut dhe prr. Rroidhesë dhe prr. Shtremberit.

Ujërat nëntokësorë, ashtu si në të gjithë Bregun e Detit, janë të pakta dhe përfaqësohen gati krejtësisht nga burime karstike të llojeve të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre burimeve shfaqen në buzë të detit (burime bregdetare) ose nën det (burime nëndetare). Kjo lidhet me faktin që malet në këtë pjesë bien drejtpërdrejt mbi det, kështu që niveli bazë i ujrave nëntokësorë është deti. Burimet kryesore këtu dalin ose në vijën bregdetare duke u përzier me ujqin e detit dhe për këtë arsye janë të kripura.


Burime të mirëfillta karstike këtu ka shumë pak dhe shfaqen në pjesët e larta të maleve ose diçka më poshtë.

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

Klima

Zona në studim bën pjesë në nëndarjen klimatike mesdhetare paramalore. Veçoritë e klimës për zonën në studim kushtëzohen nga ndikimi i fuqishëm i detit Jon dhe barrierat orografike që e rrethojnë nga lindja e veriu dhe që e mbrojnë nga erërat e ftohta që vijnë nga brendësia e vendit.

Temperatura mesatare vjetore është 17.0 OC, temperatura e janarit si muaji më i ftohtë është 10.3OC dhe e korrikut si muaji më i nxehtë 24.8OC. Karakteristikë për zonën në fjalë janë temperaturat relativisht të larta gjatë sezonit të dimrit.




Grafiku i temperaturës mesatare mujore për zonën në studim

Periudha e vegjetacionit në këtë rajon nuk njih ndërprerje. Ditët me temperaturë mesatare më të vogël se 10OC janë shumë të pakta dhe të përqëndruara gati krejtësisht në janar dhe shkurt, ndërkohë që periudha me temperaturë më të madhe se 10OC zgjat 315-330 ditë në vit.

Zona karakterizohet nga reshje atmosferike të konsiderueshme, të cilat shfaqen kryesisht në formë shiu. Kjo sasi e konsiderueshme lidhet me faktin se erërat e lagështa perendimore përplasen mbi shpatet e ftohta të vargmaleve bregdetare jonike, ku avujt kondensohen dhe bien në trajtë reshjesh. Bora është një dukuri e rrallë në zonë, përjashtuar lartësitë e mëdha si Vunoi.


Grafiku i sasisë mesatare të reshjeve sipas muajve të vitit



Regjimi i reshjeve atmosferike për zonën në studim është tipik i karakterit mesdhetar me maksimum në periudhën e dimrit dhe minimum gjatë periudhës së verës. Karakteristikë tjetër për regjimin e reshjeve në zonë është edhe intensiteti i madh i tyre. Sasitë deri në 100 mm për 24 orë janë dukuri e zakonshme, ndërkohë që ka raste që bien 300 mm e më shumë

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

për të njëjtin interval kohe. Sasitë më të mëdha 24 orëshe vërehen në periudhën e vjeshtës për shkak të aktivitetit ciklonik në këtë periudhë.



Grafik i përgjithësuar i shpërndarjes së reshjeve në zonën e Bregut të Detit

Erërat më karakteristike që ndeshen në zonën në studim janë briza dhe murrhani. Briza ndeshet më shumë gjatë muajve të verës, por nuk përjashtohet edhe gjatë ditëve të ngrohta në stinën e dimrit.

Mjedisi biologjik

Mjedisi detar

Aktiviteti i akuakulturës zhvillohet në det dhe për rrjedhojë, mjedisi i vetëm biologjik është ai detar. Mjedisi i zonës ku propozohet të zhvillohet veprimtaria ka pak a shumë të njëjtën fizionomi biologjike si i gjithë bregdeti i Jonit.

Të dhënat për florën dhe faunën detare të zonës së Bregut evidentojnë rreth 131 lloje algash makrofitë, 251 llojesh peshqish, 104 lloje dekapodësh dhe 84 lloje moluskësh. Popullatat bentonike të Shqipërisë paraqesin një fizionomi tipike mesdhetare. Prezenca në këto ujëra e llojeve të rralla të peshqve si *Luvarus imperialis*, *Ranzania laevis*, *Coelorhynchus coelorhynchus*, *Lebistes reticulatus*, venë në pah vlerat dhe pasuritë unike të ujrave të Jonit. Habitata të rëndësishme për peshqit konsiderohen edhe livadhet e *Posidonia sp.* në thellësitë e 4- 5 m. Këto livadhe janë tepër të rëndësishme për ushqimin e strehimin e një numri të madh llojesh, përfshi peshqit, krustacet dhe invertebrorëvt. Faza e supralitoralit evidentohe nga prezenca e *Cyanobacteria* ku zhvillohen *Littorina*. Kjo fazë shtrihet vertikalisht deri në thellësinë nën 1 m në zonat e qeta. Në aspektin fizik të bregdetit jugor shkëmbor karakteristike janë llojet e *Cyanophyceae sp.*, *Gastropods Littorina sp.* dhe *Cirripeds Chtamalus depressus*. Zona e mediolitoralit përfaqësohet nga cilësia e ujrave dhe prezenca e *Coralligenous algae* të përbëra nga *Lithophyllum sp.* që shtrihen përtej thellësisë vertikale më shumë se 1 m. Zona e infralitoralit shtrihet lokalisht në zonën e mbi 45 m thellësi.

Infralitorali përbëhet kryesisht nga *Cystoseira sp.* me *Padina sp.*, *Acetabularia sp.*, *Cymadocea sp.* mbi të cilat ushqehen lloje peshkore si *Sarpa salpa* etj.

Biocenoza më e rëndësishme në këtë zonë është bari i detit *Posidonia oceanica*, prodhimtaria primare e të cilit vlerësohet 21 t të lëndës së thatë/ha/vit. Livadhet e *Posidonia oceanica* janë vlerësuar si indikatorë të cilësisë dhe shëndetit të mirë të ujrave të detit dhe përdoren si indikatorë të monitorimit. Banorë të tjerë të kësaj zone janë ekinodermatet dhe krustacet e dekapodet.

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

Cilësia e ujërave bregdetarë

Zona e propozuar për zhvillimin e projektit gjendet ndërmjet Gjirit të kakomesë dhe plazhit të sarandës (qytetit). Specifikisht për zonën në fjalë nuk ka të dhëna mbi cilësinë e ujërave bregdetarë pasi nuk përfshihet në stacionet e monitorimit, por për cilësinë e ujërave mund të gjykohet duke përdorur si referencë stacionet më të afërta në veri dhe jug, përkatësisht Borshi dhe Saranda, në kontekstin e vendodhjes përkundrejt tyre.

Referuar Raportit të Gjendjes në Mjedis 2013 (AKM), vlerësuar sipas kategorive WHO/UNEP, bazuar në rezultatet e monitorimit për treguesit mikrobiologjikë, për plazhin e Borshit cilësia e ujrave i përket kategorisë A- Cilësi shumë e mirë e ujrave, në 100 % të rezultateve, dhe është e njëjtë me periudhën e viteve 2009 – 2013.

Por kjo gjë nuk mund të thuhet për Plazhin e Sarandës, për të cilin klasifikimi është: 33 % të cilësisë së ujrave i përkasin kategorise A të cilësisë – Cilësi shumë e mirë, 17 % të cilësisë së ujrave i përkasin kategorisë B - Cilësi e mirë dhe 50 % i përkasin kategorisë D - Cilësi shumë e keqe/Marrja e masave të menjëherëshme.

Për vitin 2013 është ulur përqindja e kategorisë A- Cilësi shumë e mirë e ujrave, në krahasim me vitet 2012 dhe 2010, ndërsa është e njëjtë me vitet 2009 dhe 2011. Është rritur përqindja e kategorisë B- Cilësi e mirë e ujrave, në krahasim me vitet 2012 dhe 2009, por, është ulur në krahasim me vitin 2011. Ngelet e njëjtë me vitin 2010. Është ulur përqindja e kategorisë C – Cilësi jo e mirë e ujrave , në krahasim me vitin 2012 dhe me vitin 2009. Ngelet e njëjtë me vitet 2010 dhe 2011.

Për kategorinë D – Cilësi shumë e keqe e ujrave/ Masa të menjëherëshme e krahasuar me vitin 2012 , në vitin 2013 kjo kategori është rritur, gjithashtu është rritur edhe në krahasim me vitet 2010 dhe 2011. Kjo kategori është e njëjtë me vitin 2009.

Referuar stacioneve të monitorimit, vërehet se përkeqësimi i cilësisë së ujërave përkon me zonat më të populluara të bregdetit siç janë zona e kanalit të Çukës apo Plazhi i Fëmijëve. Me cilësi të shkëlqyer paraqitet zona në veri të Sarandës e cila është edhe më pranë zonës ku propozohet të zhvillohet akuakultura.

E ndodhur ndërmjet këtij sektori të plazhit të Sarandës (kategorizuar me A) dhe plazhit të Borshit, ujërat e të cilit gjithashtu i përkasin kategorisë A, mund të themi me siguri se edhe ujërat e zonës ku do të zhvillohet aktiviteti janë të kategorisë A, me cilësi të shkëlqyer.


Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore. Ato shpallen me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe në zbatim të Ligjit nr.8906 datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, sipas kategorive përkatëse zbatohen shkallë të ndryshme mbrojtjeje.

Zona e propozuar për zhvillimin e projektit nuk ndërpret asnjë prej zonave të mbrojtura të vendit tonë.

Njëkohësisht ajo nuk ka pikëprerje as me ndonjë nga monumentet e natyrës të rrethit të Sarandës, shpallur të tilla me VKM nr. 676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”.

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**



Mjedisi socio-ekonomik

Administrativisht zona bregdetare pranë së cilës propozohet të zhvillohet aktiviteti akuakulturë gjendet në territorin e komunës Lukovë të rrethit të Sarandës, në qarkun e Vlorës.

Komuna Lukovë, e përbërë prej 9 fshatrash, shtrihet në një gjatësi prej 35 kilometrash, thuajse tërësisht, në bregdetin e Jonit dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 150 000 ha. Terreni kryesisht kodrinor i territorit ka favorizuar frutikulturën dhe veçanërisht kultivimin e ullirit.

Komuna ka një popullsi prej rreth 10 000 banorësh që krahas turizmit llogarisin ndër aktivitetet e rëndësishme ekonomike përpunimin e ullirit, ndërtimtarinë, etj. Banorët janë të vendosur në fshatrat Lukovë, Borsh, Fterrë, Çorraj, Piqeras, Sasaj, Qazim Pali, Shën Vasil dhe Nivicë.

Një punë e mire është bërë për furnizimin me ujë të qendrave të banuara kryesisht përmes mbështetjes prej donatorëve të ndryshëm, ndërkohë që shumë mbetet për t’u bërë për sistemin e kullim – vaditjes dhe përpunimin e mbetjeve.

5 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerren prej fazave gjate ndertimit te ketij kompleksi. Ne fazen pas perfundimit te veprimtarise ky objekt do funksionoje si Servis Automjetesh dhe duhet te pajiset me leje mjedisore te tipit A, B ose C.

Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte. Efektet e mundshme nga projekti qe do te implementohet do te vleresohen ne menyre te pergjitheshme nga ky raport VNM-je. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

5.1. Ndikime te rendesishme gjate ndertimit

5.1.1. Shkarkime ne uje

Nuk kemi ndotje te ujerave nentokesore. Ujerat qe dalin nga aktiviteti i ketij objekti jane ujera urbane te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit human te pnonjesve dhe rezidenteve pas perfundimit te punimeve ndertuese. Gjithashtu nuk ka ndonje ndotje toksike nga ky aktivitet, pasi nuk do te magazinohen lende te demshme per mjedisin.

Do te kemi konsumim te ujit dhe gjate vaditjes se mjedisit te gjelberuar por konsumimi i tij do te perdoret me eficence nga personat pergjegjes per mirembajtjen e mjedisit te gjelberuar perreth, kjo gjate fazes se funksionimit.

5.1.2. Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer mund te vijne nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit dhe materialit te germuar te siperfaqes se tokes. Gjithashtu djegia e lendes djegese, qe do te vije vetem nga automjetet qe do te frekuentojne kete ambjent, si dhe ne raste te rralla kur ka mungese te energjise elektrike dhe do te linde nevoja per ndezjen e gjeneratorit. Pra mund te themi se niveli i shkarkimeve do te jete i ulet, kjo vjen si rezultat se mjetet rrugore qe qarkullojne jane konform normave te percaktuar.

Nga punimet ndertuese do te kete perhapje te pluhurave nga qarkullimi i mjeteve, nga derdhja e materialeve ndertuese si ambalazhe te cimentos, stukos, etj. Perdorimi i reres, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit te siperfaqeve perreth, si dhe nga transporti i automjeteve te dheut te germuar jashte ambjenteve te kantierit te punes.

5.1.3. Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe do te prodhohen do te vijne kryesisht nga mjetet rrugore si dhe nga perdorimi i vincave te ndryshem, gjeneratoreve, zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete kantier, proceset e hedhjes se betonit, etj.

Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të shfaqen efekte ekstra-auditive si: rritje të stresit, bezdisjes, dhimbje koke deri në ulje të aftësisë së dëgjimit, etj. Kjo do të sillte ulje të produktivitetit dhe rritje të mundësive të aksidenteve.

Nuk do të shkaktohen vibrime shqetësuese gjatë funksionimit të aktivitetit.

5.1.4. Ndikimi në toke

Keto procese nuk do të ndikojnë negativisht në toke, kjo vjen si rezultat se gjatë funksionimit nuk do ushtrohen veprimtari që kanë lidhje me ndryshime të tokës apo dheut.

Terreni i këtij objekti përveç sipërfaqeve të gjelberuara do të jetë i gjithi i sistemuar dhe i shtruar me beton dhe pllaka dekoruese, gjë e cila e eliminon mundësinë për të pasur kontakt me tokën.

5.1.5. Ndikimi në flore/faunë

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti i këtij objekti nuk do të ndikojë në flore dhe faunë. Sipërfaqja ekzistuese është me bimësi barishtore.

5.1.6. Mbetjet e prodhuara

Mbetje të ngurta që do të prodhohen nga konsumi i përditshëm do të jenë mbetjet e ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre, mbetje organike, etj, të prodhuara nga banoret e kësaj ndertese gjatë ndërtimit, dhe gjatë funksionimit, si dhe mbetje të ambalazheve dhe të dheut të sipërfaqes së tokës gjatë punimeve ndërtimore.

Keto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Komunen Kashar dhe firma ricikluese të përshtatshme për keto lloje mbetjesh. Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar.

5.2. Ndikime të tjera

Rekomandojmë që objektit ose ambjenteve në vecanti, tu kryhet termoizolim për të kursyer energjinë në ngrohje dhe në ftohje, si dhe përdorimin e energjisë elektrike ose të sistemit të kalduarave me gas. Menaxhimi i sistemit të ngrohjes dhe izolimi i ambjentit ndikon në mënyrë të drejtperdrejtë në uljen e konsumit të energjisë dhe si rrjedhojë edhe ndotjen e teknologjisë së prodhimit dhe transmetimit ose transportimit të burimit të energjisë. Në përmbledhje impakti social – ekonomik do të jetë pozitiv.

6 MASAT KRYESORE LEHTESUESE

6.1 Masat lehtesuese qe do te ndermerren gjate shfrytezimit te objektit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe do te zbatohen nga kontratuesit per zbatimin e projektit. Ndikimet negative ne mjedis gjate shfrytezimit te objektit jane ne nivele te ulta. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar.

- Lagia e shesheve te pa shtruara gjate punimeve te ndertimit dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri per te minimizuar ngritjen e grimcave te ngurta (pluhurave) ne ajer.
- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga Komuna dhe te vendosen kosha te mjaftueshem per numrin e popullsisë.
- Te menaxhohen ne menyre te sigurt mbetjet me perberje te elementeve te rrezikshem si asbesti ne bashkepunim me institucionet perkatese.
- Sistemi i shkarkimit te ujerave urbane te jete i lidhur me sistemin e kanalizimeve te zones.
- Perdorimi i materialeve termoizoluese ne banese.
- Te sistemohet dhe rehabilitohen sheshet e lira dhe lulishtet e objektit pas perfundimit te punimeve ne procesin karabina te objektit.
- Te respektohen oraret e qetesise publike dhe te mos punohet ne oret e vona.
- Automjetet e transportit te qarkullojne me shpejtesi te ulet ne zonat e banuara.

7 PROGRAMI MONITORIMIT

7.1. Skema e monitorimit te treguesve mjedisor.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.

Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.

Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.

Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi eshte detyre e shoqerise investitore ne nivel individual per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te Vendimit Nr.1189. date 18.11.2009 Per monitorimet ne Republiken e Shqiperise

Investitori do te monitoroje keto treguese te trysnise ne mjedis vetem gjate fazes se punimeve ndertimore dhe konkretisht elementet e meposhtem:

- Per ajrin duhet te monitoroje Lenden e Ngurte Pezull(LNP) dhe zhurmat (dB).
- Per ujin, nuk aplikohen detyrime
- Per token, nuk aplikohen detyrime

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet ne aktin e miratimit te lejes se mjedisit dhe ne rast te kundert, sipas kuadrit ligjor cdo 6 muaj te kryhen matjet dhe cdo tre muaj te dorezohet nje relacion periodik i shkurter ku te pasqyrohen punimet e kryera te shoqeruara me foto.

**“FABRIKE PER PERPUNIMIN DHE AMBALAZHIMIN E UJIT TE PIJSHEM”
FSHATI FTERE, NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE, RRETHI SARANDE, QARKU
VLORE**

- Ndertimi i Fabrikes per perpunimin dhe ambalazhimin e ujit te pijshem, te realizohet ne nje vendodhje tjeter ku te mos preki territorin e zones se mbojtur. Ky vendim te merret se bashku me Ministrine e Mjedisit.
- Te zbatohet projekti i ndertimit dhe perdorimi i fasadave cilesore per te krijuar nje pamje estetike.
- Leja e ndertimit te zbardhet me te dhenat urbanistike te percaktuara ne projektin e paraqitur.
- Te kryhet lagia e siperfaqeve te germuara, atyre me inerte dhe te rrugeve komunikuese gjate sezonit te thate.
- Te kryhet rrethimi i kantierit te ndertimit gjate punimeve ndertuese dhe te vendosen postera paralajmerues per rreziqet per kalimtarët dhe punonjesit.
- Te kryhet larja e automjeteve para daljes se tyre ne rruget e asfaltuara te zones.
- Te reduktohet qarkullimi ne oret e pikut te trafikut, per te mos krijuar trafik te renduar ne zone.
- Te mos perdoren boriet ne qendrat e banuara dhe qarkullimi te kryhet me shpejtesi te ulet.
- Te vendosen kosha per mbajtjen paster te ambjenteve per numrin e popullsise se re.
- Te menaxhohet dheu i germuar per hapjen e themeleve, duke u sistemuar ne nje vend te caktuar nga Komuna dhe te paisur me miratim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit.
- Te zbatohen rregullat teknike gjate punes ne kantier, punonjesit te punojne nen drejtimin e drejtuesit teknik.
- Zhvilluesi te respektojte te gjitha masat e percaktuara ne kete raport te VNM.
- Zhvilluesi te respektojte dhe zbatoje ndertimin e infrastruktures teknike ne objekt per mbrojtjen nga zjarri.



LICENCË

LN-7282-01-2014	NUIS/NIPT: K81317002P
Subjekti: ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS	
Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet Agimi, Shkalla 4, Apartamenti 68	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 16/01/2015	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	Shërbime eksperte dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis	
2. Auditim mjedisor	
Specialiteti	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis. (Auditimi mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis.)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i sportelit:

Shefqete Balliu



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”


GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K81317002P	
2. Data e Regjistrimit	17/01/2008	
3. Emri i Subjektit	ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	15/01/2008	
6. Kohëzgjatja	Nga: 15/01/2008 Deri:	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Bulevardi Bajram Curri, Pallatet Agimi, Shkalla 4, Apartamenti 68	
8. Kapitali	52.000.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	- Ne fushen e mjedisit: Vleresimi i ndikimit në mjedis, ekspertize dhe auditim mjedisor, plan menaxhimi dhe plan rehabilitimi mjedisor, monitorim i treguesve mjedisor, menaxhim projektesh, konsulence.- Ne fushen e pasurive të paluajtshme: Vleresim të pasurive të paluajtshme, vleresim asetesh, ekspertize, studim tregu imobiliar, konsulence teknike dhe ligjore në fushen e pasurive të paluajtshme, supervizion dhe kolaudim punimesh për objekte ndertimi, projektim arkitektonik, inxhinierik dhe projekte zbatimi.	
10. Administratori/ët	Elidiana Shehu	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 16/06/2011	Deri: 16/06/2016
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Elidiana Shehu	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 52.000.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		



13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS Telefon: 0692076779 Të Tjera: Depozitim i vendimit nr.1 date 08.06.2010 ku caktohet si ekspert kontabel i regjistruar per rritjen e kapitalit Znj.Lumturije Brahaj me liçense nr.121.
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 04-05-2015


Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 5113 Prot.

Tiranë, më 28.07 2013

Nr. identifikues 146

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011
Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të
Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për
pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe
auditimin mjedisor":

Znj. ELIDIANA SHEHU

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për
të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme
mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të
ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDUN





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Notere: *Albana B. Skana*
Nr. 636 Rep.

albanaskana@yahoo.com 00355 672021400

VËRTETIM
(i njësisë së kopjes me origjinalin)

Sot, më datën 11.07.2013 përpara meje Noteres Albana B. Skana, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me adresë Rr. « Teodor Keko », (Unaza e Re), Yzberish, u paraqit personalisht shtetasja :

Shoqëri « **EMC** » shpk me NIPT -K81317002P me përfaqësues ligjor , Znj. **Elidiana Shehu** , atësia Bujar, e datëlindjes 15.05.1979, lindur në Tepelënë banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me dokumentin ID Nr. H95515079H , e cila kërkoi vërtetimin e njësisë me origjinalin të kopjes së dokumentit si më poshtë :

1-Certifikatë nr.5113 Prot dt.08.07.2013, nr. Identifikues 146 në emër të **Elidiana Shehu**, lëshuar nga MMPAU .

Shtetasja e mësipërme deklaroi nën përgjegjësinë e saj personale, në njohje të plotë të pasojave që sjell një dokument i falsifikuar, se ky dokument është origjinal . Pasi verifikova se dokumenti i mësipërm nuk ka korrigjime, shtesa, fshirje e shenja të tjera dhe bazuar në nenin nr.56 të ligjit nr.7829 dt.01.06.1994 »Për Noterinë « (i ndryshuar) dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr.6291 datë 17.08.2005 pika 3,4,7 Unë Noterja vërtetoj se :

« **Njësia është kopje e njëjtë me dokumentacionin origjinal** ».



NOTERE
Albana Skana



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Notere: Albana B. Skana

Nr. 99 Rep.

Nr. 43 Kol.

Taksa e pullës u pagua

albanaskana@yahoo.com +355672021400

KONTRATË PUNE

Sot, më datën, 14.01.2015 përpara meje Noteres Albana B. Skana, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me adresë :Rr. « Teodor Keko », (Unaza e Re), Yzberish u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilat kërkuan redaktimin e kësaj kontrate si më poshtë vijon :

PALAPUNËDHËNËSE: Shoqëria « **ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS** » shpk me NIPT -K81317002P, me përfaqësues ligjor , Znj. **Elidiana Shehu** , atësia Bujar, e datëlindjes 15.05.1979, lindur në Tepelenë banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me dokumentin ID Nr. H95515079H .

PALA PUNËMARRËSE : **Altin Ahmeti** , atësia Luan, i datëlindjes 20.09.1976 , lindur në Sarandë , banues në Rr. Petro Korçari, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me me dokument personal pasaportë me nr. H60920077P.

Te dy palët në marrëveshje midis tyre dhe me dëshirën e tyre të lirë, kërkuan nga unë Noterja, Perpilimin e Kontratës Punës që vijon:

-Pala Punëdhënëse merr në punë Palën Punëmarrëse me detyrën e **Drejtuesit Teknik** të Shoqërisë « **ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS** » Shpk, për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, auditimin dhe hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore etj , i pajisur me **Çertifikatë nr.11657 prot, nr. indentifikues 261 dt.10.12.2014 nga Ministria e Mjedisit.**

-Kjo kontratë pune lidhet për një periudhë 1(një) vjeçare e filluar nga data **08.01.2015**

-Paga mujore do të jete **60,000 (gjashtëdhjetë mijë) Lekë** dhe do të paguhet në datën 1(një) te çdo muaji.

-Pala Punëdhënëse është e detyruar ti sigurojë Palës Punëmarrëse të gjitha kushtet e nevojshme që ajo të ushtrojë qetesisht detyrën e saj.

-Orari i punës është tetë orë. Me marrëveshje të palëve orari mund te ndryshojë.

-Pala Punëdhënëse i paguan Palës Punëmarrëse sigurimet shoqërore e shendetësore në masën që përcakton ligji.

-Pala Punëmarrëse gëzon të drejtën e pushimit javor dhe atij vjetor.

-Pala Punëmarrëse duhet të respektojë disiplinën në punë dhe rregulloren e kesaj shoqërie, për shkeljen e tyre kjo kontratë mund të zgjidhet para afatit.

-Për mosmarrëveshjet që mund të lindin gjate zbatimit të kësaj kontrate, palët do të përipiqen që ti zgjidhin ato me mirëkuptim, në te kundërt do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë u hartua ne bazë të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995, "Kodi I Punës", të ndryshuar.



Kjo kontratë u hartua ne katër kopje origjinale me fuqi të barabarta secila, nga një kopje të kontratës e marrin palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Noterisë dhe një kopje dërgohet në Zyrën e Noterisë.

Sa më sipër, kontrata u redaktua, u lexua me zë, kuptohet nga palët dhe me vullnetin e lirë e të plotë të tyre, nënshkruhet nga palët në prani të Noteres dhe unë Noterja pasi u binda për vullnetin e deklarimit lejoj nënshkrimet dhe i legalizoj ato sipas ligjit.

PALËT

PUNËDHËNËSI

Shoqëria “ **ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS** ” shpk

Përfaqësues ligjor

Elidiana Shehu




PUNËMARRËSI


ALVIN AHMETI



NOTERE

Albana Skana





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11657 Prot.

Tiranë, më 10.12 2014

Nr. identifikues 261

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ALTIN AHMETI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Lefter KOKA

